



## **Ndihmë për viktimat – përshkrim i shkurtër**

### **01 Çka është ndihma për viktimat**

Ndihma për viktimat, është një ndihmesë e rregulluar me ligj, që ju ofrohet viktimave që kanë përjetuar dhunë. Kjo ofrohet nga ana e shtetit si solidarizim për viktimat që kanë pësuar akte të dhunës.

### **02 Kush ka të drejtë shfrytëzimi të kësaj ndihmese?**

Ju keni të drejtë shfrytëzimi të ndihmes për viktimat, nëse keni pasoja apo dëme trupore, seksuale apo pasoja psikike nga ndonjë veprim i denueshëm konform ligjeve penale.

Ndihmesa për viktimat, për shembull, vjen në shprehje dhe mund të shfrytëzohet nëse ka pasoja me lëndime trupore, të vrasjeve, dhunimeve, shfrytëzimit seksual, kërcënimeve të rënda, marrje peng apo dhunimeve.

Të drejtën e shfrytëzimit të ndihmës për viktimat, njihërit mund t'a shfrytëzojnë edhe të afërmit e viktimës, si p.sh. bashkëshorti apo bashkëshortja apo fëmijët tuaj, apo edhe personat e tjerë të afërm.

### **03 Çka keni të drejtë si person viktime?**

#### **Ndihme për keshillim**

Të punësuarit dhe të punësuarat në keshillimoret për viktimat nga ushtrimi i dhunës, ju njoftojnë mbi mundësitë që mund të shfrytëzoni, por ju ndihmojnë edhe në procesin e perpunimit të dhunës së përjetuar nga veprat e kriminit. Nëse shihet e arsyeshme, ju ndërmjetsojnë edhe persona profesional apo ju përfaqësojnë apo shoqërojnë nëse ju dëshironi, edhe në procedurat e marrjeve në pyetje që zhvillohen nga ana e organeve të hetuesis.

Keshillimi është falas, i besueshëm dhe nëse ka nevojë edhe anonim. Nëse ka nevojë, për bisedat e keshillimit, organizohet edhe asistimi i një perkthyesi apo perkthyesje.

Për sa i përket keshillimeve dhe ofertave për viktimat e veprimeve kriminele në kantonin e Cyrihut, mund të shihni adresat e poshtëshenuara, ndërsa për sa u përket Keshillimeve në kantonet e tjera mund të shihni në faqen e Webit, nën

**[www.opferhilfe-schweiz.ch](http://www.opferhilfe-schweiz.ch)**.

## Ndihma financiare

Nëse keni nevojë edhe për ndihmë tjetër, përveç asaj që ju ofrohet në këshillimore, pra ndihmën nga persona profesional, shpezimet për keso rastesh, por mvarësiht nga rrethanat e posaçme, mbulohen pjesërisht apo tërësisht nga ana e Organizates për ndihmë viktimave, (p.sh. këtu është fjala për shpenzimet e mbrojtjes së avokatures, apo shpenzimet për terapi)

Ju keni të drejtë edhe për mbulimin e kompenzimeve të damit të përjetuar apo të shkaktuar, nëse për arsye të ndikimit nga akti penal, p.sh. nuk keni qenë në gjendje të punoni. Në rastet e delikteve me pasojë-vrasje, të afërmit kanë të drejtë kompenzimi të shpenzimeve të ceremonisë së varrimit.

Të drejtë shfrytëzimi të kompenzimit për damin, si formë e dhimbjes së përjetuar apo rivënien e damit, mendohet-nëse nga akti i përjetuar penal, keni pasojë të thella dhe mendohet se gjatë nuk do ripërtrihet ai dam i përjetuar.

Këshillimoret për viktimat ju njoftojnë mbi të gjitha të drejtat t'uaja dhe ju ndihmojnë në përpilimin e kërkesave për kompenzim financiar.

### **Ju lutemi, keni parasysh, keto që vijnë:**

- E drejta e shfrytëzimit të kompenzimeve financiare, mvaret prej gjendjes financiare të kerkuesit/es. Veçanti paraqet, e drejta e kompenzimit të dhimbjes së shkaktuar.
- Nga ana e Organizates për ndihmë viktimave, destinohen ndihmat financiare, në rastet kur Organizatat e sigurimeve (p.sh. sigurimi për mbulesën e komenzimit për raste lëndimesh) apo edhe vete akteri apo shkaktuesja/i e veprës nuk mbulojnë damet e shkaktuara.
- Mbulimi i kompenzimit financiar bëhet vetëm për damet të cilat edhe mund t'i deshmoni se u janë shkaktuar dhe të cilat lidhen direkt si pasojë e veprës së dhunës që keni përjetuar si viktimë. Mbulesa e dameve materiale (p.sh. gjasendet e vjedhura, tesha të çkyera etj.), nuk mundet të mbulohen nga kompenzimet financiare të ndihmes për viktimat.
- Kërkesat për mbulimin e dameve dhe kompenzimit për dhimbjen e përjetuar, duhet të bëhen në afatin prej 5 vitesh, prej kohës kur keni përjetuar atë akt, dhe ato kërkesa drejtohen në kantonin ku ka ndodhur vepra. Njoftime më të hollësishme mund të merrni tek Këshillimoret për ndihmë viktimave të dhunës.

Kërkesat për kompenzime financiare në Kantonin e Cyrihut, duhet të drejtohen në adresën vijuese: Kantonale Opferhilfestelle, Postfach, 8090 Zürich.

Për sa i përket kompenzimeve që u drejtohen kantoneve tjera, adresat mund të merren në faqen e internetit:

**vgl. [www.opferhilfe-schweiz.ch](http://www.opferhilfe-schweiz.ch)**



## 04 Mbrojtja dhe te drejtat ne proceduren e ndjekjes penale

Në procedurën hetimore, në rolin e viktimës keni të drejta të posaqme per sa i përket, të drejtës së informatave, te mbrojtjes apo të pjesëmarrjes në ate procedure. Viktimat e veprimeve te dhunës apo dhunës seksuale apo personat e moshës minore, kanë të drejta të posaqme të mbrojtjes. Si policia ashtu edhe keshillimoret per viktimat, ju njoftojnë për të drejtat t'uaaja gjatë procedurës hetimore.



## **Keshillimore për viktimat, me status të legjitimuar ne Kantonin e Cyrihut**

### **Ofertat dhe adresat**



#### **Opferberatung Zürich Fachstelle der Stiftung Opferhilfe Zürich**

Gartenhofstrasse 17, 8004 Zürich  
Tel. 044 299 40 50

Ofertat e keshillimeve ju rekomandohen meshkujve, femrave, të rinjve dhe fëmijëve, që kanë përjetuar ndonjë akt të veprimit kriminel apo që kanë pësuar pasoja të lendimeve trupore apo kane pasoja psikike, nga ndonjë ndeshje në komunikacion. Njëherit, të drejtë ndihme kane edhe te afërmit e tyre. Te drejtë shfrytëzimi të keshillimeve kane edhe meshkujt apo te rinjtë, që jane viktima të ndonjë dhune seksuale, njëherit edhe te afërmit e tyre.

**[www.opferberatung-zürich.ch](http://www.opferberatung-zürich.ch)**



#### **bif Beratungs- und Informationsstelle für Frauen Gegen Gewalt in Ehe und Partnerschaft**

Postfach 9664, 8036 Zürich  
Tel. 044 278 99 99

Ofertat e keshillimeve te bif ju drejtohen te gjitha grave, të cilat kanë perjetuar dhunë fizike apo psikike ne partneritet, por edhe për gjithë personat e tyre të afërt apo edhe per personat që punojnë në keto lami.

**[www.bif-frauenberatung.ch](http://www.bif-frauenberatung.ch)**



#### **Frauenberatung sexuelle Gewalt**

Langstrasse 14, 8004 Zürich  
Tel. 044 291 46 46

Oferta e keshillimeve ju drejtohet grave, të cilat kanë perjetuar apo u është cenuar integriteti i tyre seksual apo kanë përjetuar dhune trupore. Gjithashtu të drejte shfrytëzimi kane edhe personat e tyre të afërm familjar apo me afersi të ngushtë.

**[www.frauenberatung.ch](http://www.frauenberatung.ch)**

 **Beratungsstelle Frauen-Nottelefon –  
Opferhilfe für Frauen - gegen Gewalt**

Technikumstrasse 38, Postfach 1800, 8401 Winterthur  
Tel. 052 213 61 61

Oferta e keshillimeve ju drejtohet grave, të cilat kanë perjetuar apo u është cenuar integriteti i tyre seksual apo kanë përjetuar dhune trupore. Gjithashtu të drejte shfrytezimi kane edhe personat e tyre të afërm familjar apo me afersi të ngushtë.

[www.frauennottelefon.ch](http://www.frauennottelefon.ch)

 **Castagna – Beratungsstelle für sexuell ausgebeutete Kinder,  
weibliche Jugendliche und in der Kindheit ausgebeutete Frauen**

Universitätstrasse 86, 8006 Zürich  
Tel. 044 360 90 40

Oferta e keshillimeve ju drejtohet të efërmëve apo peroanve të besueshëm të të rinjve apo të rejave, apo grave, të cilat kanë përjetuar keqperdorim apo dhunim seksual në fëmijëri, apo personave të tyre të afërm.

[www.castagna-zh.ch](http://www.castagna-zh.ch)

 **Fachstelle OKey &  
KidsPunkt**

St. Gallerstrasse 42, 8400 Winterthur  
Tel. 052 245 04 04

Kantonsspital Winterthur / DKJ  
Brauerstr. 15, Postfach 834, 8401 Winterthur  
Tel. 052 266 41 56

Oferta e keshillimeve ju drejtohet fëmijëve dhe të rinjve apo të afërmive të tyre apo personave të tyre të besueshëm – apo edhe perosnave profesionistë që punojnë me fëmijët që kanë perjetuar keqperdorim apo dhunim seksual.

[www.okeywinterthur.ch](http://www.okeywinterthur.ch)

 **Kinderschutzgruppe und Opferberatungsstelle  
des Kinderspitals Zürich**

Steinwiesstrasse 75, 8032 Zürich  
Tel. 044 266 76 46 (Sekretariat Kinderschutzgruppe)  
Tel. 044 266 71 11 (Telefonzentrale des Kinderspitals)

Oferta e këshillimeve ju drejtohet fëmijëve apo të rinjve si dhe të afërmëve të tyre apo personave të tyre të ngushte që punojnë me fëmijët që kanë perjetuar keqperdorim (inkl. dhunim seksual).

**[www.kinderschutzgruppe.ch](http://www.kinderschutzgruppe.ch)**

 **Beratungsstelle kokon  
Krisenintervention und Opferhilfe für Kinder und Jugendliche in Not**

Gemeindestrasse 48, 8032 Zürich  
Tel. 044 545 45 40

Oferta e këshillimeve ju drejtohet fëmijëve që kanë perjetuar dhunën apo të rinjve bashke me rrethin e tyre, por edhe bashke me të riun/të renë por edhe për personat që punojnë në kete sektor.

**[www.kokon-zh.ch](http://www.kokon-zh.ch)**

 **FIZ Makasi, Interventionsstelle für Opfer von Frauenhandel\***

Badenerstrasse 682, 8048 Zürich  
Tel. 044 436 90 00

Oferta e këshillimeve në FIZ Makasi, ju drejtohet grave të cilat janë viktime e trafikimit me femra, siç parashihet konform Nenit 182 të Ligjit penal të Zvicrës.

**[www.fiz-info.ch](http://www.fiz-info.ch)**

\* FIZ Makasi si ent intervenimi, për viktimat, nuk është e njohur nga ana e Kantonit në rangun institucional. Por, për gratë të cilat kanë qëndrim në kanton dhe janë viktime e trafikut me femra, percjellja e tyre financohet nga ana e institucioneve tjera, konform ligjit për viktime.